

# *Vështirësitë kryesore në përvetësimin e parafjalëve në gjuhën angleze*

*Avni Islami\**

## **Abstrakti**

Përvetësimi i parafjalëve në gjuhën angleze nuk është detyrë e lehtë për ata që e mësojnë anglishten si gjuhë të dytë apo të huaj. Ky studim specifikon se zotërimi i parafjalëve në gjuhën angleze është një nga parakushtet për t'u aftësuar që këtë gjuhë ta flasim rrjedhshëm dhe me saktësi. Së pari, ky studim trajton mënyrat e përdorimit të parafjalëve në gjuhën angleze, ndërsa pastaj reflekton mbi disa nga arsyet pse parafjalët shkaktojnë vështirësi për studentët e gjuhës angleze. Ky punim gjithashtu analizon sistemin themelor që rregullon parafjalët dhe se si ky sistem mund t'u ofrohet studentëve në përvetësimin e gjuhës angleze, duke analizuar pedagogjinë aktuale të mësimdhënies dhe mandej sugjeron një alternativë adekuate. Pastaj, ky punim merret edhe me keqpërdorimin e parafjalëve nga studentët e vitit të parë të Fakultetit Ekonomik në Kolegjin Privat AAB në Kosovë, si dhe studentet e Fakultetit të Edukimit në Universitetin Publik të Prishtinës. Hulumtimi ka treguar se shumica e studentëve bëjnë gabime të përsëritura edhe me parafjalët më të zakonshme të përdorura të kohës dhe të vendit (në, të dhe në) për shkak të ndikimit të gjuhës së parë dhe pasigurisë së krijuar në prodhimin e një deklarate të përshtatshme me parafjalë të tilla. Nga ky hulumtim kam vërejtur se studentët e Fakultetit Ekonomik në AAB bëjnë me pak gabime në përdorimin e parafjalëve se sa studentët e Fakultetit të Edukimit .

**Fjalë kyç:** *përvetësimi, parafjalët e anglisht, vështirësitë, kohë.*

---

\* *Avni Islami, PhD Cand., Kolegji AAB, E-mail: avni83up@hotmail.com*

## Hyrje

Studimi i parafjalëve nuk është një detyrë e lehtë në AGJD (anglishtja si gjuhë e dytë), apo si gjuhë e huaj, për shkak të alternativave të tyre të shumta dhe natyrës së tyre polisemike në përgjithësi. Kjo ndodh për shkak se parafjalët paraqesin një sfidë të madhe për studentët e gjuhës angleze. Është shumë e rëndësishme që mësuesit të zhvillojnë metoda efektive të mësimdhënies. Në raste të tilla, mësimdhënësit e gjuhës angleze duhet të ndërmarrin hapa efektivë dhe seriozë për të aplikuar metodologji të sofistikuar, me qëllim të tejkalimit të vështirësive me lehtësi dhe sigurimit të një trajtim real të tyre në mesin e grupeve heterogjene gjatë mësimin të gjuhës. Së pari, detyra jonë është që të ofrojmë zgjidhje të duhura për vështirësi në të nxënit dhe pastaj të bëhet një analizë e dobishme. Është gjë e njohur se parafjalët kanë kuptime të shumta (Polisemike) dhe se jo rrallë marrin një kuptim të vetëm (monosemik). Polisemia është "një tipar semantik i fjalëve me kuptime të shumta".<sup>1</sup>Ky efekt i parafjalëve streson dhe frikëson studentët që e mësojnë gjuhën angleze si gjuhë të dytë, apo si gjuhë të huaj. Kuptimi i parafjalëve kryesisht varet nga konteksti i fjalisë. Së dyti, shumica e parafjalëve janë njërrrokëshe (monosilabike), siç vuri Lam në dukje, dhe janë të panjohura për studentët, ngaqë ato shqiptohen shpejt dhe u mungon qartësia gjatë shqiptimit të tyre në kontekst. Kompleksiteti i përdorimit të parafjalëve si dhe kuptimi i tyre kontekstual janë mjaft të ndryshme nga një gjuhë në një gjuhë tjetër dhe mund të krijojnë shqetësim dhe frikë te studentët. Studentët nuk mund të mbështeten në njohuritë që kanë për parafjalët në gjuhën e tyre amtare. Nëse marrim si shembull transferimin e parafjalës

---

<sup>1</sup> Randolph Quirk, Sidney Greenbaum, Geoffrey Leech and Jan Svartvik, *A Comprehensive Grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 659.

shqipe 'në' në gjuhën angleze, krijohet një vështirësi, ngaqë kjo parafjalë në gjuhën angleze mund të përkthehet me parafjalët "in" dhe "at," por nganjëherë edhe me parafjalën "on". Çdo lloj i "supozimit të ekuivalencës semantike ndërmjet gjuhës së parë dhe të dytë" do të shkaktonte gabim në përdorimin e parafjalëve. Është e qartë se anglishtja ka numër më të madh të parafjalëve se shumë gjuhë të tjera. Parafjalët në gjuhën shqipe kanë më shumë polisemi se në cilëndo gjuhë evropiane dhe se dhe se është vështirë të sistemohen.

### ***Gabimet që bëjnë studentët të cilët e mësojnë anglishten si gjuhë të huaj***

Gabimet që bëhen nga studentët që e mësojnë anglishten si gjuhë të huaj (AGJH), janë nga shkaqe të ndryshme. Në mesin e të gjitha këtyre shkaqeve, dy janë kryesore: Njeri nga gabimet shkaktohet nga ndërhyrja përmes gjuhës amtare dhe tjetri përmes ndërhyrjes nga strukturat joadekuate. Parafjalët angleze mbeten një problem i jashtëzakonshëm për çdo student të AGJH, për shkak se studenti a studentja shpesh i lidhë ato me sistemin e parafjalëve të gjuhës shqipe. Vështirësia shfaqet për shkak të ndryshimit në numër, në të kuptuarit, si dhe në përdorimin e parafjalës në gjuhën (burimore) shqipe dhe gjuhën (e synuar) angleze, si gjuhë e huaj. Të gjitha pjesët e ligjëratës mund të ndikojnë në heqjen, futjen dhe zgjedhjen e një parafjale të papërshtatshme në gjuhën angleze, e cila dëmton thelbin e idesë së synuar nga studenti. Kjo përfshirje, përdorimi idiomatik i parafjalëve, i bën ato të vështira madje edhe për ata që e kanë gjuhë amtare anglishten.<sup>2</sup> Normalisht, një parafjalë shpreh një marrëdhënie në mes dy entiteteve: ajo shpreh një

---

<sup>2</sup> Peter Watcyn-Jones Jake Allsope, *Test Your Prepositions*, Penguin Books 2000, f.778.

lidhje në hapësirë (në mes një gjëje dhe një tjetre), dhe / ose një marrëdhënie në kohë (në mes të ngjarjeve), dhe marrëdhëniet më abstrakte. Pra, karakteristika e parë është që si parafjalët e shqipes, po edhe ato të anglishtes, nuk mund të qëndrojnë vetëm; ato i marrin kuptimet e tyre në kontekste të ndryshme. Pra, problemi kryesor është së pari në faktin se jo çdo parafjalë e shqipes ka një ekuivalent të caktuar në gjuhën e synuar, përkatësisht në anglishte dhe anasjelltas, dhe, së dyti, jo çdo parafjalë e anglishtes apo e shqipes ka përdorim dhe kuptim të caktuar, duke treguar vetëm hapësirë ose kohë apo duke i paraprirë një fjale të caktuar.

### *A mund të vendosen parafjalët kudo?*

Pothuajse të gjitha parafjalët mund të vendosen në fillim të fjalisë. Një parafjalë mund të zërë një pozitë para dhe pas çdo parafjale tjetër. Jo rrallë zbatohen edhe shprehjet idiomatike, p.sh. "She thinks she is for it at the moment," "We are not up to such an inconvenient job," "She is not sure she is up for a long trip." Normalisht ajo mund të zërë një vend përpara ose pas ndonjë ndajfoljeje, foljeje, emri (ose emri foljor) dhe mbiemri, si dhe para nyjave: a, an, the dhe përemrave pronorë /his, her/her, it/its/ por assesi nuk mund të vendoset para as pas përemrave kryefjalorë (unë, ai, ajo).<sup>3</sup>

### *Qasja tradicionale*

Mënyra tradicionale e ligjërimit të parafjalëve bëhet nëpërmjet strukturave gramatikore dhe disa konteksteve. Kjo qasje nuk mund t'u garantojë studentëve një sukses dhe efikasitet në të kujtuarit se si duhet përdorur parafjalët kur të jetë e

---

<sup>3</sup> S. Lindstromberg, *English Prepositions Explained*, Philadelphia, 1998, f. 165.

nevojshme, sepse ata do të kenë në mendje që lista është shumë e paparashikueshme dhe se memorizimi i parafjalëve kontekstuale në të do të jetë praktikisht fare i pamundshëm për t'u nxënë. Lam jep më tepër detaje për këtë, "duke u përpjekur studentët të mbajnë në mend një listë të veçantë, vështirë se do të arrinin të kuptonin se si përdoren parafjalët, vetëm për arsien se e njëjta parafjalë mund të shprehë një gamë të gjerë kuptimesh". Nga kjo del se arsimtarët e gjuhës, pashmangshëm, duhet të përpiqen të ndjekin metoda më të reja që kanë kërkesa më të vogla kognitive.

### ***Qasja kolokacionale***

Parafjalët është më mirë të ligjërohen dhe mësohen "pjesë, pjesë" ose me fjalë që shkojnë shpesh së bashku (togfjalësha) se sa të ligjërohen njësi individuale të tyre, si psh: to depend on, to wait on, to step on, to work on and to rely on, etj. Për ata që merren me mësimdhënie dhe ata që mësojnë, fjala kolokacion do të thotë bashkëndodhje "(BND), apo pjesë ose sekuencë konvencionale." Në rastin e parafjalëve, këto janë zakonisht togfjalësha foljorë. Togfjalëshat foljorë, së bashku me togfjalëshat parafjalorë si, on time, on schedule, on...screen or on ...leg përveçohen më lehtë.<sup>4</sup> Kjo metodë është e dobishme, ngaqë stimulon natyrshëm ndjeshmërinë dhe lehtë-nxënien e strukturave të shpeshta gjuhësore te studentët.<sup>5</sup> Më së shpeshti të mësuarit varet nga ideja që qenia njerëzore e përpunon dhe e trajton gjuhën ashtu meqë ajo është njësi e ndjeshme. Sipas Mullerit<sup>6</sup>, "Mësimi i tillë asociativ është i nevojshëm dhe

---

<sup>4</sup> Douglas Biber, Susan Conrad and Geoffrey Leech, *Students Grammar of Spoken and Written English*, Pearson Education, Harlow, Essex, 2002, pp. 121.

<sup>5</sup> Ibid.

<sup>6</sup> Ibid.

kontribuon në nxënien e formave të rregullta dhe idiomave fikse". Shumë ekspertë dhe hulumtues të gjuhës besojnë se të përvetësuarit e gjuhës pjesë- pjesë dhe duke përdorur në mënyrë të përsëritur kontekstet kuptimplota mbushin studentin me besim, pra e ndërtojnë besimin të tij dhe e fusin atë në analiza të thella. Ligjërimi i parafjalëve përmes qasjes së kolokacionit mundëson përdorimin e korpusit dhe harmonisë. Koosha dhe Jafarpour kanë vënë në dukje se teknika e DHOGJ (Të dhënat operacionale të gjuhës) "trajton vetitë kolokacionale të gjuhës përmes vijës harmonike" dhe ka avantazh të plotë mbi metodat konvencionale.<sup>7</sup> Harmonia është një analizë e strukturave dhe modeleve leksikore në bazat e të dhënave digjitale<sup>8</sup>. Ky avantazh është manifestuar dukshëm përmes një eksperimenti të kryer nga ata në dy grupe të ndryshme; një me teknikë DHOGJ dhe tjetri me metodën tradicionale me tekste të zakonshme. (Brown Corpus Online and searched Web Concordancer janë përdorur nga Koosha dhe Jafarpourfor në studimin e tyre.<sup>9</sup> Pra, qasja kolokacionale me të dhëna autentike përmes harmonisë është më e dobishme se sa metoda konvencionale.

### *Qasja prototipike:*

Të mësuarit e thellë të parafjalëve, sipas Lindstromberg dhe Lam, është e mundur nëpërmjet metodave shpjeguese dhe kuptimit themelor, të cilat në një mënyrë e përforcojnë besimin dhe rrisin shkallën e mbajtjes mend. Teoria prototipike e Lakoff

---

<sup>7</sup> Ibid.

<sup>8</sup> Peter Watcyn-Jones Jake Allsope, *Test Your Prepositions*, Penguin Books 2000, f.778.

<sup>9</sup> Seth Lindstromberg, *English Prepositions Explained*, John Benjamin's Longman, 1987, pp. 321.

është bazë e pretendimit të këtyre dy gjuhëtarëve.<sup>10</sup> Dhe kjo teori pretendon se në mesin e kuptimeve të shumta të parafjalëve vetëm një kuptim është real ndër të gjithë të tjerët. Ky kuptim real ose dominues është prototipik. Prototipike janë edhe parafjalët me kuptim hapësinor dhe fizik. Për shembull parafjala "mbi" ka disa kuptime, por prototipike është "kontakti i një objekti me një linjë të sipërfaqes".<sup>11</sup> Duke studiuar dhe kuptuar domethënien prototipike dhe duke i analizuar ato, studentëve do t'u mundësohet të kuptojnë se kuptimet polisemike të parafjalëve janë zgjerime metaforike. Përsëri duke marrë shembullin "on", Lindstromberg shpjegon se kuptimi jo-prototipik i sintagmës "com on" mund të kuptohet përmes zgjerimit metaforik të kuptimit prototipik të "on"<sup>12</sup>. Pra kuptimet prototipike mund të mësohen përmes PFF (Përgjigjeve Fare Fizike) dhe arsimtari mund të inkurajojë zgjerimin dhe eliminimin e kuptimeve abstrakte. Krahasimi dhe kontrastimi i teknikave të parafjalëve është shumë i dobishëm për të zgjeruar më tej aspektin semantik të tyre te studentët. Lindstromberg shpjegoi kuptimin e "come on" duke e kontrastuar atë me "come back". Qasjet bazike semantike shpesh i lidhin kuptimet e ndryshme të parafjalëve në një tablo mendore duke siguruar lidhje të besueshme dhe logjike midis disa parafjalëve individuale, të cilat përndryshe duken të palidhura. Vështirësia e të mësuarit të parafjalëve nuk është vetëm në gjuhën angleze, por edhe në gjuhë të tjera, siç është vërejtur nga Lam<sup>13</sup>. Lam ka kryer një studim me dy grupe të studentëve për të gjetur se cila metodë është më e mirë në mes të qasjes kognitive gjuhësore ose të mësuarit e parafjalëve në

---

<sup>10</sup> Ibid.

<sup>11</sup> Ibid.

<sup>12</sup> Ibid.

<sup>13</sup> Seth Lindstromberg, *English Prepositions Explained*, John Benjamin's Longman, 1987, pp. 321.

mënyrë individuale. Meqë qasja kognitive gjuhësore nis me kuptimin prototipik dhe shtrihet në kuptimet metaforike, ka rezultuar të jetë shumë më e dobishme, më efektive, më e qëndrueshme dhe që mundëson të mësuarit me më pak përpjekje se sa mësimi tradicional. Qasja kognitive gjuhësore, "i mundëson arsimtarit të nxjerrë në pah marrëdhëniet midis përdorimeve të ndryshme të parafjalëve dhe përshkruan strukturat e kuptimeve të zgjeruara.<sup>14</sup> Kjo kundërshton idenë e mësimin përmendësh të secilës parafjalë veç e veç. Në këtë mënyrë, studentët me gjasë do të jenë më të vetëdijshëm për shtrirjen ekspresive të një parafjale.s" Rezultatet janë vërejtur edhe nga (Lam) se grupi i cili ka mësuar përmes qasjes kognitive gjuhësore doli mirë në test pas trajnimit.<sup>15</sup> Kjo tregon qartë se mësimi i bazuar në semantikë përshpejton rezultatin e nxënies së menjëhershme dhe zgjat mbajtjen mend të gjërave.

### *Të gjeturat*

**Analiza e gabimeve: Mësimi i parafjalëve në mesin e studentëve të Fakultetit Ekonomik në Universitetin Privat AAB dhe Fakultetit të Edukimit, Universiteti Publik në Kosovë. Pjesëmarrësit ishin studentët e vitit të parë**

Në këtë studim krahasues kanë marrë pjesë 364, gjegjësisht nga 182 studentë të zgjedhur rastësisht në Kolegjin Privat AAB në Kosovë, dhe Universitetin Publik, përkatësisht Fakulteti i Edukimit. Instrument i përdorur në studim ishin ese të shkruara nga studentët e vitit të I (parë) të Fakultetit të Ekonomisë të AAB-ës dhe të Fakultetit të Edukimit,

---

<sup>14</sup> Starvik, Jan. *A Comprehensive Grammar of English Language*, Longman, 1985, pp. 231.

<sup>15</sup> Geoffrey Leech and Jan Svartvik, *A Comprehensive Grammar of the English language*, Longman, 1985, f. 442.



Universitetit Publik me rastin e mbajtjes së provimit në fund të semestrit të parë. Provimi i semestrit të parë në lëndën e gjuhës angleze dëshmon se studentët kanë më shumë vështirësi në përdorimin e saktë të parafjalëve në gjuhën angleze se të çdo pjese tjetër të ligjëratës. Gabimet e bëra nga studentët në përdorimin e parafjalëve të shënuara në tabelarët vijues:

**Tabela 1 e rezultateve të Universitetit Privat AAB**

*Numri total dhe përqindja e gabimeve të bëra nga studentët Fakultetit të Ekonomisë gjatë vlerësimit të njohurive të parafjalëve:*

Një element	Nr i gabimeve	përqindja
Parafjalët	83	39.83%
Totali	83	39.83%

Tabela 1 tregon se numri total i gabimeve të bëra nga studentët e ekonomisë ishte 104, gjegjësisht 39.83%. Me këtë kuptojmë se studentët e ekonomisë kanë vështirësi në të mësuarit e parafjalëve.

**Tabela 2 e rezultateve të Universitetit Publik, Fakulteti i Edukimit**

*Numri total dhe përqindja e gabimeve të bëra nga studentët e Fakultetit të Edukimit gjatë vlerësimit të njohurive të parafjalëve:*

Një element	Nr i gabimeve	përqindja
Parafjalët	138	77.94%
Totali	138	77.94%

Tabela 1 tregon se numri total i gabimeve të bëra nga studentët e Fakultetit të Edukimit ishte 138 gjegjësisht 77.94%. Me këtë kuptojmë se studentët e Fakultetit të Edukimit kanë vështirësi të mëdha në të mësuarit e parafjalëve.

**Tabela 3 e rezultateve të Universitetit Privat AAB**

*Numri total dhe përqindja e gabimeve të bëra nga studentët e Fakultetit të Ekonomisë gjatë vlerësimit të njohurive në llojet parafjalëve:*

Llojet e parafjalëve	numri i gabimeve	përqindja
Parafjalët e vendit	111	56.21
Parafjalët e kohës	48	21.39
Parafjalët e kahes, drejtimit	51	28.39
Totali	210	182

Tabela 2 tregon se numri total i gabimeve në njohjen e llojeve të parafjalëve nga studentët e Fakultetit të Ekonomisë në AAB ishte 210, nga të cilat (111) 56.21 % ishin te parafjalët të vendit, (48), 21.39% te parafjalët e kohës, ndërsa (51) 28.39 % ishte te parafjalët që tregojnë lëvizje, kahe dhe drejtim. Kjo dëshmon se studentët e ekonomikut ballafaqohen më vështirësi në nxënien e parafjalëve.

**Tabela 1 e rezultateve të Universitetit Publik, Fakulteti i Edukimit**

*Numri total dhe përqindja e gabimeve të bëra nga studentët e Fakultetit të Edukimit gjatë vlerësimit të njohurive në llojet e parafjalëve:*

Llojet e parafjalëve	numri i gabimeve	përqindja
Parafjalët e vendit	92	47.39
Parafjalët e kohës	149	78.32
Parafjalët e kahes, drejtimit	62	33.36
Totali	303	182%

Tabela 2 tregon se numri total i gabimeve në njohjen e llojeve të parafjalëve nga studentët e Fakultetit të Edukimit ishte 303, nga të cilat (92) 47.39 % ishte vërejtur te parafjalët e vendit, (149), 78.32% në parafjalët e kohës, ndërsa (62) 33.36 % ishte vërejtur në parafjalët që tregojnë kahe, drejtim. Kjo dëshmon se studentët e Fakultetit të Edukimit ballafaqohen më vështirësi të mëdha në nxënien e parafjalëve.

### ***Përfundim***

Kufizimi i ndonjë strategjie të veçantë mund të jetë mbingarkesë psikologjike për disa arsimtarë dhe hulumtues. Por aplikimi i qasjes së kolokacionit dhe qasjes së prototipit me siguri do të ofrojnë më shumë ekspozim duke e rritur qëllimin e absorbimit. Sasitë më të mëdha të informacioneve u japin rast studentëve t'i lidhin përvojat e tyre me kohën reale të të mësuarit dhe se si parafjalët të përdoren në praktikën aktuale. Në të njëjtën mënyrë, Koffi thekson dobinë e nën-kategorizimit të kornizave të foljeve dhe mbiemrave. Nën-kategorizimi ndihmon studentët në zgjedhjen e parafjalëve të sakta për foljet ose mbiemrat në varësi të kontekstit. Një kuptim i ndër-marrëdhënies ndërmjet pjesëve të ndryshme të ligjëratës do të rrisë më tej të kuptuarit e nivelit të rrënjës dhe zbatimin e saktë të mundur. Për këtë arsye, arsimtarët duhet të mbështeten në burimet që janë të shëndosha dhe që janë dëshmuar të suksesshme në kapërcimin e kufizimeve të metodave tradicionale në një atmosferë mësimi.

## **Bibliografia**

Jiménez, R. M. Frequency and variability in errors in the use of English prepositions. *Miscelánea: A Journal of English and American Studies*, 17, 1996. (171-187).

Koffi, E. *Applied English syntax: Foundations for word, phrase, and sentence analysis*. Dubuque, Iowa: Kendall Hunt Publishing Company. 2010.

Koosha, M& Jafarpour, A. A. Data-driven learning and teaching collocation of Prepositions: The case of Iranian EFL adult learners. *Asian EFL Journal*, 8.

Lindstromberg, S. Prepositions: Meaning and method. *ELT Journal*, 50 (3),(1996): 225- 236. Web.25 May 2015.

Mueller, C. M. English learners' knowledge of prepositions: Collocational knowledge or knowledge based on meaning? *System: An International Journal of Educational Technology and Applied Linguistics*, 39 (4),(2011): 480-490. Web. 25 May 2015.